

8-D Ndërprerja e rrymës kushton një milion dollar

<p>Lithonia Lighting, e cila gjendet jashtë Atlantës, në Gjorgjia, është prodhuesi më i madh në botë i llusterave (për ndriçim), me më shumë se 1 miliardë në shitjet vjetore. Një pasdite, transformatori i fuqisë në bazën e korporatës eksplodoi, duke i lënë tërë kompleksin e zyreve, përfshirë edhe qendrën e të dhënave të korporatës, pa rrymë. Sistemi backup i rrymës së qendrës së të dhënave menjëherë e vazhdoi funksionin dhe i mbajti pjesët kritike të qendrës së të dhënave funksionale. Sidoqoftë, ajo ishte e pamjaftueshme për t'i furnizuar të gjitha sistemet, prandaj sistemi që i mbështeste shitjet për të gjithë agjentët, tergtarët dhe distributorët e Amerikës Veriore të Lithonia Lighting u desht të çkyqet.</p>	<p>Transformatori është zëvendësuar shpejt dhe rryma është kthyer në funksion. Sidoqoftë, ndërprerja prej 3 orësh e sistemit të shitjes kushtoi 1 milion humbje në shitjet potenciale. Fatkeqësisht, nuk është e pazakonshme që kostoja e ndërprerjes të jetë qindra apo mijëra herë më e madhe se kostoja e komponenteve të dështuara.</p> <p>PYETJA: Çka do të rekomandonit për të ju shmangur humbjeve të ngjajshme në të ardhmen?</p>
---	--

KRITIKA E WEB FAQËS

Vizitoheni faqën kryesore të Web-it për universitetin tuaj dhe orientohuni nëpërmes disa webfaqeve të tij. Vlerësoni deri në cilin nivel i plotësojnë (përmbushin) parimet e gjashtë dizajneve.

PËRDORNI ZHVILLIM TË SKENARIT PËR ËEB

Vizitoheni website-in e Universitetit tuaj dhe orientohuni nëpërmes disa webfaqeve të tij. Zhvilloni dy skenar të përdorimit për te.

Dy Skenar të Përdorimit për Rastin e Përdorimit për Kërkim dhe Shiqim të Melodive

Skenari i Përdorimit: Blerësi që shikon Përdoruesi nuk është i sigurtë se çka dëshiron të blejë dhe do t'i shiqojë disa melodi.	Skenari i Përdorimit: Blerësi në ngutje Përdoruesi e din saktë se çka ai apo ajo dëshiron dhe e dëshiron shpejt.
<ol style="list-style-type: none">1. Përdoruesi mund ta kërkojë ndonjë këngëtar specifik apo të shikojë në kategorinë e muzikës (1.2).2. Përdoruesi, me gjasë, do ta lexoj informatën bazë për disa melodi, si dhe materialin për marketing për disa prej tyre. Ai apo ajo, me gjasë, do t'i dëgjojë mostrat e muzikës dhe do t'i shiqojë meloditë (1.3).3. Përdoruesi do ta vendosë melodinë në karrocë për blerje (1.3) dhe do të vazhdojë të shiqojë (1.2).	<ol style="list-style-type: none">1. Përdoruesi do të kërkojë këngëtarin apo melodinë specifike (1.2).2. Përdoruesi do të shikoj çmimin dhe mjaft informata tjera për ta konfirmuar se melodia është melodia e dëshiruar (1.3).3. Përdoruesi do të dëshirojë ta blejë shkarkimin (procesi 2) apo të shkojë te Web faqet tjera.

<p>4. Eventualisht, përdoruesi do të dëshirojë ta blejë shkarkimin, por sigurisht do të dëshirojë të shikojë në karrocën për blerje, mundësisht që t'i largojë disa melodi së pari (1.3).</p> <p>Numrat në kllapa i referohen numrave të procesit në DFD.</p>	
---	--

SHËRBIMET E KARIERËS

Konsideroni një formular të Web-it të cilën studenti do ta përdorte për të futur informata për studentin dhe informata për rezyme në aplikacionin për shërbime të karrierës në universitetin tuaj. Skiconi se si ky formular do të dukej dhe identifikoni fushat të cilat do t'i përfshinte formulari. Çfarë lloj kontrollimesh të vlefshmërisë do të përdornit ju për t'u siguruar se informatat korrekte futen në sistem?